



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 04.03.2013
Nr. 0204-213

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, 01 Nr. 320-5160, Pranuar me datë, 27.02.2013.

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit 01. nr. 320-5160, të miratuar me datë 24.01.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi 01. nr. 320-5160, Vendimi për Dhënie e Pajisjeve në Shfrytëzim NPL „Hortikultura“ Sh. A. në Prishtina.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL
Udhëheqëseve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 04.03.2013

Nr. 0204-213

Za: Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Pristina
Sami Hamiti, Predsedvajući Skupštine Opštine Pristina

PREDMET: POTVRDA ZAKONITSOTI ODLUKE OPŠTINE PRISTINA, 01 br. 320-5160, Primitjeno dana, 27.02.2013.

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti Kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke 01. br. 320-5160, usvojene dana 24.01.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ocenjuje da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt koji je naveden u nastavku ima puni pravni efekat.

- Odluka 01. br. 320-5160, Odluka o davanju opreme nakorišćenje NPL„Hortikultura“ A. D. Priština.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar u MALS-a
Rukovodiocima uprava MALS-a
Arhivu MALS-a



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008) dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 24.01.2013, miratoi këtë

V E N D I M
P Ë R
DHËNIEN E PAJISJEVE NË SHFRYTËZIM NPL "HORTIKULTURA" SH.A.
NË PRISHTINË

I.

Miratohet Vendimi për dhënie e pajisjeve në shfrytëzim ndërmarrjes publike lokale "Hortikultura" në Prishtinë.

II.

Pajisjet e dhëna në shfrytëzim sipas pikës I të këtij vendimi, janë:

1. Kamioni i markës "IVECO" / 75 E 18, me vinç (shportë), viti i prodhimit 2012, me numër të shasisë ZCFA 75D0402571499;
2. Frezë bore e tipit "STEM" 13070E, 8 copë, frezë bore të tipit "STEM" 14076 ET, 3 copë;
3. Kositëse rrotative vetëlëvizëse e tipit "VIKING" MB6R, 5 copë.

III.

Dhënia e pajisjeve të cekura në pikën II të këtij vendimi, bëhet për 15 vjet.

IV.

Qëllimi i dhënies së pajisjeve në shfrytëzim, të cekura në pikën I të këtij vendimi, është ngritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve për mirëmbajtjen e sipërfaqeve publike, pastrimin e borës nga sipërfaqet publike dhe krasitjen e drurëve.

V.

NPL "Hortikultura" SH.A. është e obliguar që pajisjet e dhënë në shfrytëzim t'i mirëmbajë në gjendje të rregullt dhe, pas kërkesë së Komunës, t'i kthejë në posedim të saj.

VI.

Kushtet tjera të dhënies në shfrytëzim do të rregullohen me marrëveshje të veçantë, të lidhur në mes të Kryetarit të Komunës dhe NPL "Hortikultura" SH.A.

VII.


Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorja e Financave dhe e Pronës.

VIII.

Ky vendim hyn në fuqi tetë (8) ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve të Komunës dhe në ueb- faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. nr. 320-5160, më 24.01.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Samir Hamiti, ecc. i dipl.



Faqe 2 nga 2

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosove
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://www.prishuna-komuna.org>